



**AKCESK**

AUTORITETI KOMBËTAR PËR  
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK  
DHE SIGURINË KIBERNETIKE

**ASP** AKADEMIAE  
STUDIMEVE  
POLITIKE

# RAPORT MONITORIMI

MESAZHET QË NXISIN EKSTREMIZMIN  
E DHUNSHËM NË PLATFORMAT  
ONLINE NË SHQIPËRI

**Autorë:**

Edlira Gjollëshi  
Esmeralda Hasani  
Saimir Kapllani

**Konsulent:**

Erjon Tase

Janar 2023

**Projekti “Sinjalizues të besuar për një ekosistemin  
kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm”**

Ky studim u hartua falë bashkëpunimit me disa prej insitucioneve të sigurisë në vend. Një mirënjohje e veçantë u drejtohet të gjithë ekspertëve vendas që kanë vendosur bazat për metodologjinë e monitorimit të mesazheve ekstremiste online.



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania

Botimi është pjesë e projektit “**Sinjalizues të besuar për një ekosistemin kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm**”, i mbështetur financiarisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

© Akademia e Studimeve Politike



**AKCESK**

AUTORITETI KOMBËTAR PËR  
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK  
DHE SIGURINË KIBERNETIKE



# RAPORT MONITORIMI

## MESAZHET QË NXISIN EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM NË PLATFORMAT ONLINE NË SHQIPËRI

**Projekti “Sinjalizues të besuar për një ekosistemin  
kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm”**

**Autorë:**

Edlira Gjollëshi  
Esmeralda Hasani  
Saimir Kapllani

**Konsulent:**

Erjon Tase

Janar 2023



## TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	5
2. ZHVILLIMET AKTUALE	6
3. METODOLOGJIA E PROCESIT TË MONITORIMIT	7
4. ANALIZA E MONITORIMIT	15
4.1 MEDIAT SOCIALE	15
4.1.1 FACEBOOK	16
4.1.2 YOUTUBE	17
4.1.3 INSTAGRAM	18
4.1.4 TWITTER	18
4.1.5 TELEGRAM, TIKTOK, REDDIT, VIMEO, LOJËRA	19
4.2 FAQET WEB	21
4.3 REFERENCA TË GJETURA SIPAS FJALËVE KYÇE	21
4.4 GJINIA E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË PËRHAPJEN E PËRMBAJTJEVE EKSTREMISTE NË INTERNET	23
4.5 KRAHASIMI ME MONITORIMIN E VITIT 2019	23
5. PËRFUNDIME	24
6. REKOMANDIME	25
SHTOJCA 1 - MOTORËT E KËRKIMIT	26
SHTOJCA 2 - DISA REFERENCA TË GJETURA NGA MONITORIMI	29
SHTOJCA 3 - FJALËT KYÇE PËR MONITORIM	29

## 1. HYRJE

---

Kanë kaluar rreth tre vite që nga vlerësimi i parë i kërcënimeve të ekstremizmit të dhunshëm në hapësirën online në gjuhën shqipe, i zhvilluar nga Akademia e Studimeve Politike (ASP) në bashkëpunim me “Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” (QKEDH) dhe “Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike” (AKCESK). Ky monitorim mundësoi një vlerësim bazë të mesazheve ekstremiste dhe gjuhës së urrejtjes që nxisnin radikalizimin në platformat online dhe evidentoi boshllëqet në kuadrin ligjor, bashkëpunimin institucional dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të tjerë publikë dhe privatë për të kundërshtuar këtë problem shqetësues për sigurinë kombëtare.

Gjuha shqipe ishte një nga pesë gjuhët e përdorura në komunikimin propagandistik zyrtar të Shtetit Islamik të Irakut dhe Sirisë (ISIS) në periudhën 2014-2019, duke synuar radikalizimin dhe rekrutimin e luftëtarëve në të gjitha trevat shqiptare në rajonin e Ballkanit. Pavarësisht mposhtjes ushtarake të shtetit të vetëshpallur të ISIS me marrjen edhe të territorit të fundit të kontrolluar prej tij në mars 2019, ndjekësit e tij patën mundësi të arratisen dhe të vazhdojnë, tashmë në mënyrë jo aq të dukshme, përpjekjet për të mbjellë farat e brezit të ri të ekstremistëve dhe rifituar shkëlqimin e humbur.

Tashmë me përvojën e duhur për përdorimin e internetit për propagandë, forcat ekstremiste vijnë të shpërndajnë mesazhet e tyre të urrejtjes të mbrojtur nga mundësitë që ofron përdorimi i hapësirës “të errët” të internetit dhe profileve të rreme në mediat sociale. Në situatën e re të shtrirjes intensive të përdorimit të internetit dhe zhvillimit të teknologjisë, veçanërisht gjatë pandemisë së Covid-19, kjo hapësirë kibernetike është kthyer në një terren edhe më të frytshëm për propagandën ekstremiste.

Si rrjedhojë, është e rëndësishme që të zhvillohet një vlerësim periodik i kërcënimeve në hapësirën kibernetike dhe nivelit të shpërndarjes së materialeve që nxisin ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin e përdoruesve të cenueshëm. Ky monitorim i dytë, i zhvilluar në fundin e vitit 2022, përmbledh eksperiencën më të mirë të krijuar nga grupi i ekspertëve të angazhuar në monitorimin e parë të vitit 2019, duke përfshirë gjithashtu zhvillimet e fundit gjeopolitike dhe teknologjike si rezultat i pandemisë globale dhe agresionit rus ndaj Ukrainës.

## 2. ZHVILLIMET AKTUALE

---

Politikat në Shqipëri që lidhen me teknologjinë, komunikimet elektronike dhe inovacionin kanë vijuar të nxisin zgjerimin e shërbimit të internetit në të gjithë vendin si dhe konkurrencën e lirë ndërmjet operatorëve elektronikë privatë për ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe ofrimi i tyre përmes platformës e-Albania, duke mundësuar lehtësira për qytetarët dhe bizneset, ka patur gjithashtu presion pozitiv për rritjen e kërkesës për shërbimin e internetit në vend. Të gjitha këto arsye kanë ndikuar që numri i përdoruesve të internetit të rritet sërish.

Sipas statistikave të INSTAT, 88.3 përqind e familjeve shqiptare patën qasje në internet në vitin 2021, duke shënuar një rritje me 5 përqind nga një vit më parë.<sup>1</sup> Krahasuar me përqindjen e familjeve që kanë pasur qasje në internet në Bashkimin Evropian për vitin 2021, që ishte 92%<sup>2</sup>, rezulton që Shqipëria është në të njëjtin nivel me disa nga vendet anëtare të BE-së nëse u referohemi statistikave të OECD-së<sup>3</sup>. Duke patur një popullsi të re në moshë, në vendin tonë përdoren intensivisht telefonat celularë smartphone, të cilët e ofrojnë kudo dhe me kosto të ulët shërbimin e internetit, ku 98.7 % e individëve kanë përdorur aparat celularë/ telefona inteligjent (smart) për të hyrë në internet.<sup>4</sup>

Të dhënat e INSTAT për vitin 2021 zbulojnë gjithashtu se përdorimi i internetit “çdo ditë/ pothuajse çdo ditë”, ka regjistruar përqindjet më të larta ndër vite për të gjitha grupmoshat, ku vendin kryesor e zënë grupmoshat 16 - 24 vjeç me rreth 97,2 % si dhe grupmoshat 25 - 34 vjeç, 97.4%. Përdorimi i internetit sipas gjinive, tregon se meshkujt janë përdorues më të shumtë, me 80,3 % të përdoruesve, në krahasim me 78,3 % përdoruese femra,<sup>5</sup> por vihet re se pabarazia gjinore tek përdoruesit ka pësuar rënie duke shënuar vetëm 2 përqind krahasuar me 5.2% që ishte në vitin 2019.<sup>6</sup> Duhet të nënvizojmë se pandemia e Covid-19 bëri të domosdoshme shtrirjen e internetit dhe përdorimin e telefonave smart edhe në zonat më të thella të vendit si dhe ulë ndjeshëm moshën e përdoruesve të mitur për shkak të zhvillimit të mësimin online apo nevojës për të komunikuar me familjarët gjatë periudhës së izolimit.

Së bashku me këtë zhvillim pozitiv të shtrirjes së përdorimit të internetit, është rritur potenciali për ekspozimin e shoqërisë, dhe sidomos e të rinjve dhe fëmijëve, ndaj rreziqeve të ndryshme që qarkullojnë në hapësirën online. Të rinjtë dhe fëmijët, duke qenë përdoruesit më të shumtë në numër dhe më të predispozuar t'u besojnë të panjohurve, janë më të shënjestruar nga grupet që e përdorin hapësirën kibernetike për qëllime të paligjshme. Në këtë realitet të ri virtual, grupet radikale dhe ekstremiste kanë siguruar një mënyrë efikase për të përhapur ideologjitë e tyre si dhe bashkëpunuar dhe bindur ndjekës pa asnjë limit gjeografik apo moshor. Grupet e njohura të ekstremizimit të dhunshëm, të tilla si grupet e lidhura me ISIS, por jo vetëm, kanë shfrytëzuar teknologjitë elektronike për shpërndarjen e propagandës së tyre dhe zgjerimin e rrjeteve të tyre përmes rekrutimeve online. Sipas Raportit të EUROPOL<sup>7</sup> për terrorizmin të publikuar në vitin 2020:

*“Rajoni i Ballkanit Perëndimor mbeti strehë për komunitetet e radikalizuara. Përveç kthimit të luftëtarëve të ISIS (FTF-ve), kërcënimi i terrorizmit gjithashtu buron nga radikalizimi i grupeve dhe individëve, përfshirë ata që vuajnë dënimin në burg. Këto mjedise përfshijnë anëtarë të organizatave terroriste të njohura dhe grupe informale, por gjithashtu edhe individë që vetë-radikalizohen në internet, për shembull përmes kontakteve me ideologë xhihadistë.”*

<sup>1</sup> INSTAT, Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje, 2021 [tik-ne-familje-2021.pdf](#)

<sup>2</sup> Statistika mbi aksesin në internet, Statista, <https://www.statista.com/statistics/377585/household-internet-access-in-eu28/>

<sup>3</sup> Statistika mbi aksesin në internet, OECD, <https://data.oecd.org/ict/internet-access.htm>

<sup>4</sup> INSTAT, Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje, 2021 [tik-ne-familje-2021.pdf](#)

<sup>5</sup> [tik-ne-familje-2021.pdf](#)

<sup>6</sup> <http://www.instat.gov.al/media/6435/anketa-mbi-p%C3%ABrdorimin-e-teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt-2018-2019.pdf>

<sup>7</sup> [European Union Terrorism Situation and Trend report \(TE-SAT\) 2020](#)



Është përt'u theksuar konstatimi i trendeve negative rritëse në nivel evropian dhe global sa i përket veprimtarisë së grupeve që kanë arritur t'u shmangen mekanizmave të ndjekjes dhe arrestimit të forcës së ligjit dhe që vazhdojnë veprimtarinë e tyre online. Sipas një komunikimi të Rrjetit të Ndërgjegjësimit mbi Radikalizimin mbështetur nga Komisioni Evropian, "*pandemia Covid-19 ndikoi në rritjen e ekstremizmit të grupeve të majta dhe të djathta radikale përmes propagandës antiqeveritare dhe dezinformimit me qëllim për të nxitur njerëzit drejt dhunës*".<sup>8</sup> Sipas UNITAR, janë evidentuar disa trende negative lidhur me sfidat e reja në fushën e parandalimit dhe luftës ndaj ekstremizmit të dhunshëm si rezultat i ndikimit të pandemisë Covid-19, ku rritja e rekrutimit online, rritja e shpërndarjes së dezinformimit dhe teorive konspirative, modifikimi i strategjive për sulme të dhunshme, si dhe gjetja e mënyrave të reja për të financuar terrorizmin, janë disa prej tyre.<sup>9</sup> Disa prej tyre janë vërejtur edhe në Shqipëri, ku teori konspirative të ndryshme rreth pandemisë dhe "qeverisjes globale të elitave", që nxisnin reagime kundërshtuese ndaj masave kufizuese të marra nga qeveria për izolimin dhe vaksinimin anti-Covid, u përhapën gjatë pandemisë dhe vijojnë të jetë aktive gjerësisht në hapësirën online nga grupe politike dhe lëvizje të ndryshme aktiviste.

Shqiptarët, ishin një nga grupet e targetuara nga propaganda online e ISIS në vitet 2014-2019, e cila rezultoi efektive për radikalizimin dhe rekrutimin e qindra luftëtarëve dhe familjeve të tyre nga trojet ku jetojnë në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë. Një studim i mbështetur nga Akademia e Studimeve Politike në vitin 2015<sup>10</sup>, zbuloi një strategji të sofistikuar komunikimi online publik të ISIS në gjuhën shqipe, me synim rekrutimin e tyre si luftëtarë në zonat e konfliktit. Gjuha shqipe ishte gjithashtu një nga pesë gjuhët e përdorura për komunikimin në atë që cilësohej faqja zyrtare online<sup>11</sup> e ISIS, duke dëshmuar edhe njëherë rrezikshmërinë që mund të përbëjë ky grup terrorist për radikalizimin e shqiptarëve edhe në këtë situatë të re. Megjithatë, përmbajtjet ekstremiste mund të përhapen brenda territorit shqiptar në hapësirën kibernetike edhe në gjuhë të tjera të tilla si gjuha angleze apo arabe nga shtetas shqiptarë ose të huaj, duke targetuar audiencë shqiptare që i nje dhe kupton këto gjuhë.

Përballë këtyre zhvillimeve, është e nevojshme që institucionet ligjzbatuese të forcojnë mekanizmat e monitorimit dhe bashkëpunimit me industrinë e teknologjisë dhe telekomunikacionit për të identifikuar dhe adresuar sfidat e reja dhe ofruar një mjedis më të sigurt online.

### 3. METODOLOGJIA E PROCESIT TË MONITORIMIT

Ky monitorim synoi të identifikojë nivelin e mesazheve nxitëse të ekstremizmit përmes internetit në Shqipëri me synim evidentimin e trendeve të reja për të marrë masat e nevojshme për të ofruar një mjedis elektronik të sigurt.

<sup>8</sup> Website i Komisionit Evropian, Migrimi dhe Punët e Brendshme, komunikim mbi lëvizjet anti-qeveritare dhe ekstremizmin e dhunshëm, [https://home-affairs.ec.europa.eu/networks/radicalisation-awareness-network-ran/ran-media/ran-spotlight/spotlight-covid-19-violent-extremism-and-anti-government-movements\\_en](https://home-affairs.ec.europa.eu/networks/radicalisation-awareness-network-ran/ran-media/ran-spotlight/spotlight-covid-19-violent-extremism-and-anti-government-movements_en)

<sup>9</sup> UNITAR Factsheet, <https://unitar.org/sites/default/files/media/file/Factsheet%20CT%20Printed.pdf>

<sup>10</sup> Strategjia e komunikimit online publik të ISIS në Shqipëri - 2015 [http://www.asp.al/pdf/Strategjia\\_e\\_komunikimit\\_te\\_IS\\_-\\_Koncept\\_paper\\_13\\_Nentor.pdf](http://www.asp.al/pdf/Strategjia_e_komunikimit_te_IS_-_Koncept_paper_13_Nentor.pdf)

<sup>11</sup> <https://hilafeti.wordpress.com>

Më konkretisht, procesi i monitorimit pati si objektiva:

1. Kërkimi, identifikimi dhe analiza e përmbajtjeve me prirje ekstremiste në Shqipëri në platformat online (faqe interneti, blogje, rrjete sociale etj);
2. Specifikimi i platformave online të përdorura, rrjeteve sociale, website-ve për të shpërndarë përmbajtje ekstremiste;
3. Ofrimi i statistikave të vlefshme për ndërtimin e politikave përkatëse.

Procesi i monitorimit u mbështet në metodologjinë e krijuar tashmë nga monitorimi i parë, duke përfshirë studimet dhe praktikat më të mira të SHBA dhe Komisionit Evropian në këtë fushë.<sup>12</sup>

Sipas Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2022-2025, *“Ekstremizmi i dhunshëm është ai proces i adoptimit të pikëpamjeve radikale (politike, ideologjike ose fetare) dhe kthimit të tyre në veprime të dhunshme nëpërmjet kërcënimit, nxitjes, inkurajimit bazuar në baza ideologjike me synimin për të shkaktuar frikë dhe pasiguri.”*<sup>13</sup>

Në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm online, kërkues të ndryshëm kanë dhënë përkufizimet e tyre në punë të ndryshme kërkimore. Bazuar mbi përkufizimin e Mc Farlane (2010), u përcaktua se çfarë mund të përkufizohet si ekstremizëm i dhunshëm online. Sipas studiuesit: “ekstremizëm i dhunshëm online përkufizohet përdorimi i sistemeve të komunikimit online si mjet për shtyrjen dhe/ose influencimin e individëve dhe grupeve për të zhvilluar, adaptuar dhe/ose avancuar sisteme besimi që shtrihen jashtë normave të pranura nga shoqëria, duke rezultuar në mbështetjen e kërcënimeve dhe/ose akte fizike të dhunës për të përhapur këtë sistem besimi”<sup>14</sup>.

Bazuar mbi këto përkufizime mbi ekstremizimin e dhunshëm u zgjodh të përdoret për monitorimin metodologjia e analizës së përmbajtjes, nëpërmjet kërkimit me fjalë kyçe, për të kuptuar narrativën, grupin e shenjëstruar në Shqipëri dhe platformat elektronike të përdorura. Metodologjia e përdorur konsistoi në ndërtimin e një liste të fjalëve kyçe që mund të çonin përdoruesit drejt përmbajtjeve ekstremiste, kur ato futen në motor kërkimi. Këto fjalë kyçe u kategorizuan bazuar në llojin e tyre ideologjik dhe rrezikun e mundshëm që lidhet me to.

Motorët e kërkimit të përdorur ishin “BrandMentions”, “Brand24” dhe “Social Searcher”, me anë të të cilave janë gjeneruar të dhënat lidhur me fjalët kyçe. Elementet e kërkimit u bazuan edhe në fjalët kyçe të përdorura në studimet e Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), përse i përket përhapjes së propagandës dhe thirrjeve për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin në Shqipëri.

Ekspertët verifikuan më tej këto të dhëna të gjeneruara në formën e linkeve, që përmbajnë fjalët kyçe dhe kanë potencial për të qenë përmbajtje të lidhura me ekstremizmin e dhunshëm, duke filtruar dhe analizuar me qëllim klasifikimin e përmbajtjes së tyre. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave u realizua nga kërkues me eksperiencë në çështjet e monitorimit të ekstremizmit të dhunshëm si dhe komunikimit online, gjatë dy muajve në periudhën **Nëntor-Dhjetor 2022**. Monitorimi është bërë për përmbajtje në gjuhën shqipe, por duke shtuar edhe atë angleze dhe arabe, të dedikuara/aksesuara për Shqipërinë, duke përdorur opsionet e filtrimit të mjeteve të përdorura për monitorimin.

<sup>12</sup> Website i Komisionit Evropian, Migrimi dhe Punët e Brendshme, publikim [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers_en)

<sup>13</sup> Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025, dhe Plani i Veprimit 2021–2023 [https://kon-sultimipublik.gov.al/documents/RENJK\\_507\\_Strategjia%20Nd%C3%ABrsektoriale%20AT%20dhe%20CVE.pdf](https://kon-sultimipublik.gov.al/documents/RENJK_507_Strategjia%20Nd%C3%ABrsektoriale%20AT%20dhe%20CVE.pdf)

<sup>14</sup> McFarlane, B., Online Violent Radicalisation (OVER): Challenges Facing Law Enforcement Agencies and Policy Stakeholders, Monash University, 2010



Kategoritë e përcaktuara për klasifikimin e përmbajtjeve janë: dezinformimi, diskriminimi fetar, propaganda fetare, propaganda anti-fetare, ekstremizmi politik që përfshin ekstremizmin politik të të majtës ekstreme dhe ekstremizmin politik të të djathtës ekstreme, përmbajtje lidhur me konfliktin etnik dhe luftën etnike, implikime ekstremistësh dhe terroristësh, ekstremizmi islamist, teoritë konspirative, antisemitizmi, dezinformimi, përmbajtje të tjera ekstremiste, përmbajtje neutrale dhe përmbajtje fetare. Për secilën nga këto fjalë kyçe, u konstatua numri i personave ose llogarive që propagandojnë ideologji ekstremiste, përfshirë këtu edhe ekstremizmin etnik, politik etj.

### Kategorizimi i Fjalëve Kyçe<sup>15</sup>

Për të identifikuar nivelin e rrezikut të lidhur me secilën fjalë në përmbajtjen ku bëjnë pjesë, fjalët kyçe u ndanë në kategoritë:

- Kategoria 1: Fjalë ekstreme, të dhunshme
- Kategoria 2: Fjalë kyçe të përgjithshme

Kategorizimi i fjalëve kyçe të tilla si “vrasja e të pabesëve” ose “vrasja e apostateve” janë në thelb me përmbajtje të dhunshme, ndërsa të tjerat, siç janë ‘kryqëzatat’ ose ‘kalifati’ janë më të përgjithshme në natyrën e tyre, për këtë arsye përmbajtja e tyre duhej të analizohej me kujdes, me qëllim që të mos ndikonte të drejtën e lirisë së fjalës, mendimit, dhe të besimit.<sup>16</sup>

Fjalë kyçe me risk të lartë	Fjalë kyçe të përgjithshme
Jelek vetëvrasësi	Dëshmor
Vrasja e apostujve	Xhihad

*Tabela nr.1: Kategorizimi i fjalëve kyçe*

Midis kategorive ishte e pashmangshme mbivendosja, megjithatë përcaktimi pasqyroi vetëm natyrën e fjalës dhe jo lidhjet e saj me ndonjë grup të veçantë. Kjo do të thotë që koncepti i “khilafah” është më i lidhur me ISIS-in, por vetë fjala nuk ka domethënie të dhunshme apo ekstreme. Si rezultat, ajo u kategorizua në listën e fjalëve politike islamike.

### Përhapja e Fjalëve Kyçe

Të dhënat për përdorimin e fjalëve kyçe, u siguruan duke iu drejtuar mjeteve online të kërkimit<sup>17</sup>, ku nëpërmjet të dhënave historike, u filtruan rezultatet specifike me përmbajtje lidhur me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Meqenëse monitorimi nuk kishte qasje në të gjitha të dhënat historike që mund të ekzistojnë në internet për platformat/rrjetet e monitoruara, përqindjet e numrit të linkeve të gjeneruara për fjalët kyçe të cilat përmenden në to, mund të përdoret si një udhëzues i dobishëm për popullaritetin e fjalëve të përdorura në internet, por nuk japin shifra përfundimtare.

<sup>15</sup> Shtojca 3, fjalët kyçe për monitorim

<sup>16</sup> EU Human Rights Guidelines on Freedom of Expression Online and Offline <https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/142549.pdf>

<sup>17</sup> Shtojca 1, Motorët e kërkimit

Frekuencat lokale u mblodhën për të gjitha fjalët kyçe duke zgjedhur si opsion tek mjetet e monitorimit filtrin që gjeneronte linket ku përmenden këto fjalë sipas shteteve, në rastin konkret për Shqipërinë. Të dhënat për frekuencat e fjalëve arabe nuk korrespondojnë ekskluzivisht me zonën gjeografike arabe, por arsyetimi për të zgjedhur fjalët kyçe në gjuhën arabe dhe zhvilluar monitorim për përmbajtje në këtë gjuhë, vjen nga fakti se, është gjuha e përdorur nga grupime të ndryshme ekstremiste pa dallim kufinjsh. Gjatë analizës së të dhënave, u identifikuan llogaritë si dhe personat, kur ishte e mundur, të cilët ishin aktivë në faqet e internetit, mediat sociale, youtube, ku gjendeshin fjalët kyçe, si dhe u nxorën statistika mbi gjininë e tyre dhe kategoritë e përmbajtjeve që ata përhapin.

### Kategorizimi i përmbajtjes

Kategorizimi i përmbajtjes u krijua për të pasur një pasqyrë më të detajuar të llojit të përmbajtjes ku gjenden fjalët kyçe të analizuara. Përcaktime të përmbajtjes së gjetur në një website nuk pasqyrojnë gjykimin për një faqe të tërë, por vetëm të përmbajtjes ku ndodhej fjala kyçe.

Kategoritë	Ekstreme	Neutrale	Anti-fetare
1	Të dhunshme		
2	Jo të dhunshme		
3	Politike Islamike		
4		Lajme, Analizime, Ideologji fetare	
5		Shoqëria Civile	
6		Qeveritare	
7		Grupe Fetare	
8			Anti-islamike, anti- krishterim, etj

Tabela nr.2: Kategorizimi i përmbajtjeve ku gjenden fjalët kyçe

*Grupimi mbi përmbajtjen ekstreme* u nda në tre nën-kategori; i dhunshëm, jo i dhunshëm dhe përmbajtje politike radikale të grupeve terroriste. Përmbajtjet u kategorizuan si të dhunshme nëse ato përmbanin imazhe grafike të dhunës ose nxitje të dhunës.

Përmbajtjet që u vlerësuan të jenë ekstreme, por jo të dhunshme ishin ato që shprehnin pikëpamje antisemite, homofobike, raciste ose sektare, por pa nxitur dhunën. Kategoria përmbajtje politike radikale përfshinte përmbajtje, të cilat shprehnin një prirje specifike ndaj një grupi të veçantë islamik. Kjo kategori në mënyrë të qartë iu referua grupeve të njohura politike, që janë duke kërkuar në mënyrë aktive për të fituar pushtet politik.

*Grupimi mbi përmbajtjet neutrale* përfshin webfaqet kryesore të mediave, faqet e internetit, të cilat përhapin ideologji fetare, si dhe përmbajtjet e prodhuara dhe/ose shpërndara nga grupet e shoqërisë civile, grupet qeveritare dhe grupet fetare. Për grupet fetare, kjo përfshin organizata të njohura fetare, si dhe individë me prirje islamike, të cilët përhapin ideologji mbi besimin e tyre.

*Grupimi mbi përmbajtjen anti-fetare* përfshin disa fjalë kyçe ku ekziston prania e vazhdueshme e informacionit me përmbajtje ekstremiste kundër besimeve fetare të tilla si mysliman, të krishterë dhe besimeve të tjera.

## Kategoritë e përmbajtjeve dhe përkufizimet

- Dezinformim

Sipas përkufizimit të Oxford Reference, dezinformimi është një formë propagande që përfshin shpërndarjen e informacionit të rremë me qëllim për të mashtruar ose keq-orientuar.<sup>18</sup> Tek kjo kategori, janë klasifikuar ato përmbajtje të cilat përfshijnë fjalët kyçe të përdorura për monitorimin e kontaminimit të internetit, përhapin informacione të rreme dhe lidhen me pikëpamje ekstreme, por që nuk mund të klasifikohen tek kategoritë e tjera.

- Diskriminim fetar

Diskriminimi fetar është trajtimi i individëve ndryshe për shkak të besimeve dhe praktikave të tyre fetare, dhe/ose kërkesës së tyre për përshtatje të besimeve dhe praktikave të tyre fetare. Ai gjithashtu përfshin trajtimin e individëve ndryshe për shkak të mungesës së besimeve ose praktikave fetare.

Praktikat fetare nuk janë vetëm ato që kërkohen nga një kishë ose një grup tjetër fetar, por përfshijnë besime morale ose etike për atë që është e drejtë dhe e gabuar, të cilat mbahen me forcën e pikëpamjeve tradicionale fetare. Besimet mund të jenë “fetare” në natyrë edhe nëse asnjë grup fetar nuk ka besime të tilla ose grupet fetare të cilave u përkasin të tjerët në vendin e punës nuk i pranojnë këto besime.<sup>19</sup>

- Propaganda fetare

Sipas përkufizimit të Oxford Reference, propaganda është një komunikim masiv bindës që filtron dhe kornizon çështjet e ditës në një mënyrë që favorizon fuqimisht interesa të veçanta; zakonisht ato të një qeverie ose korporate. Gjithashtu, konsiderohet edhe si manipulimi i qëllimshëm i opinionit publik përmes gënjeshtreve, gjysmë të vërtetave dhe ritregimit selektiv të historisë.<sup>20</sup> Në rastin e propagandës fetare, mund të përkufizohet si një lloj propagande që zhvillohet për qëllime të favorizimit të interesave të një besimi fetar të caktuar duke manipuluar opinion publik përmes përhapjes së ideologjisë fetare në mënyrë objektive ose të keqinterpretuar apo ndryshuar sipas qëllimeve që synohen të arrihen. Kjo lloj propagande ka natyrën e nxitjes e urrejtjes fetare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar që mund të jetë në formën e propagandës që synon mbajtjen e kontrollit politik në duart e një elite fetare kundër besimeve të tjera fetare në një shoqëri. Mund të përdorë të gjitha llojet e mediave dhe të shkaktojë luftë, terrorizëm, trazira, dhe dhunë, dhe të maskojë padrejtësitë dhe pabarazitë, shfrytëzimin dhe mizoritë duke nxitur apati dhe tjetërsim përmes injorancës. Propaganda fetare përkeqësohet nga intoleranca fetare dhe indoktrinimi fetar.<sup>21</sup>

- Propaganda anti-fetare

Propagandë që zhvillohet në kundërshtim me idetë, besimet dhe organizatat fetare. Në këtë kategori janë klasifikuar përmbajtjet të cilat jo thjesht shprehin pikëpamje ateiste, por kundërshtojnë, ironizojnë, dhe hedhin poshtë besimet fetare ekzistuese, shpesh në mënyrë imponuese dhe përmes informacioneve të pabazuara, duke shprehur qëndrime ekstreme dhe duke synuar një audiencë të gjerë në internet.

<sup>18</sup> <https://www.oxfordreference.com/display/10.1093/oi/authority.20110803095721660;jsessionid=1C0598946044489A11C08D711D976834>

<sup>19</sup> [Religious Discrimination | U.S. Department of Commerce](#)

<sup>20</sup> Përkufizimi i propagandës sipas Oxford Reference [Propaganda - Oxford Reference](#)

<sup>21</sup> Përkufizimi i propagandës fetare [Religious propaganda | The Encyclopedia of World Problems \(uia.org\)](#)

- Ekstremizmi politik dhe dhuna politike

Ekstremizmi politik mund të përkufizohet si ideologji politike që mohon apo kundërshton demokracinë dhe shkel të drejtat e njeriut si dhe favorizon regjimet autoritare. Ekstremizmi politik ndahet në dy lloje: ekstremizëm politik i të djathtës ekstreme dhe ekstremizëm politik i të majtës ekstreme.

a) Ekstremizmi politik i të djathtës ekstreme

Ekstremizmi politik i të djathtës ekstreme përkufizohet nga studiuesi Cas Mudde si një ideologji që ka të paktën tre nga pesë karakteristikat e mëposhtme: nacionalizmi, ksenofobia, anti-demokracia dhe avokimin për një shtet të fortë. Ekstremizmi i të djathtës ekstreme dallohet nga radikalizmi i të djathtës ekstreme pasi ekstremistët e djathtë hedhin poshtë demokracinë (përfshirë sistemet të tilla si të drejtat e minoriteteve dhe institucioneve të pavarura) si një formë qeverisjeje në parim dhe favorizojnë sistemet autoritare të sundimit.<sup>22</sup>

“Ekstremizmi i dhunshëm i krahut të djathtë janë akte të individëve ose grupeve që përdorin, nxisin, kërcënojnë me dhunë, legjitimojnë ose mbështesin dhunën dhe urrejtjen për të çuar përpara qëllimet e tyre politike ose ideologjike, të motivuara nga ideologjitë e bazuara në refuzimin e rendit dhe vlerave demokratike si dhe të të drejtave themelore, dhe të përqendruar në nacionalizmin përjashtues, racizmin, ksenofobinë dhe/ose intolerancën e ndërlidhur.”<sup>23</sup>

b) Ekstremizmi politik i të majtës ekstreme

Ekstremizmi i të majtës ekstreme: Ekstremistët e të majtës ekstreme janë aktorë politikë, të cilët, të ndikuar nga ideologjitë komuniste dhe anarkiste, hedhin poshtë parimet e demokracisë sociale në angazhimin e tyre për ndryshime sistematike të sistemit kapitalist. Ekstremizmi i krahut të majtë karakterizohet nga kundërshtia ndaj demokracisë liberale, simpatia për regjimet autoritare dhe teori konspirative kundër demokracive perëndimore. Ekstremistët e krahut të majtë mbështeten në sfida ekstra-parlamentare kundër kapitalizmit dhe refuzojnë të kompromentohen me aktorë politikë që avokojnë për të mbajtur status quo-në.<sup>24</sup>

- Konflikt etnik dhe luftë etnike

Konflikti etnik është një formë konflikti ku objektivat e të paktën njëres palë përcaktohen në terma etnikë, dhe konflikti, shkaqet e tij, dhe zgjidhjet e mundshme përceptohen sipas linjave etnike. Konflikti zakonisht nuk ka të bëjë me ndryshimet etnike në vetvete, por me çështje politike, ekonomike, sociale, kulturore, dhe territoriale. Konfliktet në Ballkan, Ruanda, Çeçeni, Irak, Indonezi, Sri Lanka, Indi, dhe Darfur, si edhe në Izrael, Bankën Perëndimore dhe Rripin e Gazës, janë shembujt më të njohur dhe vdekjeprurës të konflikteve etnike nga fundit i shekullit XX dhe fillimi i shekullit XXI. Destabilizimi i provincave, shteteve, dhe, në disa raste të rajoneve të tëra, janë pasojë e zakonshme e dhunës etnike. Konfliktet etnike shoqërohen me shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut, të tilla si genocide dhe krime kundër njerëzimit, si dhe nga rënie ekonomike, dështim të shtetit, probleme mjedisore dhe flukse refugjatësh. Konfliktet etnike të dhunshme çojnë në vuajtje njerëzore të jashtëzakonshme.<sup>25</sup>

<sup>22</sup> Raport mbi ekosistemin e ekstremizmit online tw Zelandës së Re, [NZ-Online-Extremism-Findings-Report.pdf](#)

<sup>23</sup> Raport i Komisionit Evropian “Ekstremizmi i dhunshëm i krahut të djathtë në Ballkanin Perëndimor” [ran\\_vrwe\\_in\\_western\\_balkans\\_overview\\_072022\\_en.pdf](#) (europa.eu)

<sup>24</sup> [NZ-Online-Extremism-Findings-Report.pdf](#)

<sup>25</sup> Përkufizim i konfliktit etnik, [Ethnic conflict | Definition, Causes, Types, Examples, & Facts | Britannica](#)

- Implikime ekstremistësh dhe terroristësh

Në lidhje me ekstremizmin dhe terrorizmin nuk ka ende një përkufizim universal. Sipas përkufizimit të OECD, ekstremizmi përcaktohet si promovimi i pikëpamjeve të cilat nxisin dhe nxisin dhunën në forcimin e besimeve të veçanta, dhe nxisin urrejtje që mund të çojë në dhunë ndërmjet komuniteteve.<sup>26</sup> Personat e përfshirë në nxitjen apo kryerjen e veprave të tilla lidhur me ekstremizmin e dhunshëm, konsiderohen ekstremistë.

Sipas OKB-së, terrorizëm<sup>27</sup> nënkupton një veprim ose tentativë veprimi ku:

1. Veprimi:

(a) konsiston në marrjen e qëllimshme të pengjeve; ose

(b) ka për qëllim të shkaktojë vdekje ose lëndim të rëndë trupor të një ose më shumë anëtarëve të popullatës së përgjithshme ose segmenteve të saj; ose

(c) përfshin dhunën fizike vdekjeprurëse ose serioze ndaj një ose më shumë anëtarëve të popullatës së përgjithshme ose segmenteve të saj;

Dhe

2. Veprimi kryhet ose tentohet me qëllim të:

(a) Provokimit të një gjendje terrori në publikun e gjerë ose një segment të tij; ose

(b) Detyrimit të një qeverie ose organizate ndërkombëtare për të bërë ose për të mos bërë diçka; dhe

3. Veprimi korrespondon me:

(a) Përkufizimin e një vepre penale të rëndë në ligjin kombëtar, i miratuar për qëllimin e respektimit të konventave dhe protokolleve ndërkombëtare në lidhje me terrorizmin ose me rezolutat e Këshillit të Sigurimit në lidhje me terrorizmin; ose

(b) Të gjithë elementët e një krimi të rëndë të përcaktuar nga ligji kombëtar.

Personat e përfshirë në nxitjen apo kryerjen e veprave të tilla lidhur me terrorizmin, konsiderohen terroristë. Materialet e gjetura online që përshkruajnë raste të implikimeve të ekstremistëve dhe terroristëve në kryerjen e veprave penale të nxitjes dhe/ose kryerjes së veprave terroriste, do të trajtohen në këtë studim si përmbajtje që lidhen me implikime terroristësh.

- Ekstremizmi islamist

Ekstremizmi islamist përshkruan avokimin e një sistemi besimi që promovon krijimin e një shteti islamik përjashtues dhe totalitar, brenda të cilit, ata që nuk ndjekin këtë vizion portretizohen si një “grup i jashtëm” inferior dhe i nënshtrohen mjeteve të nënkuptuara, të qarta ose të dhunshme të nënshtimit dhe paragjyqimit. Ekstremistët islamikë propagandojnë një mendësi ç’njerëzimi të të tjerëve, që është në kundërshtim me pluralizmin dhe zbatimin universal të të drejtave të njeriut. Grupet ekstremiste ndjekin dhe mbrojnë një ndryshim sistematik politik dhe shoqëror që reflekton botëkuptimin e tyre. Ata mund ta bëjnë këtë përmes mjeteve jo-të dhunshme

<sup>26</sup> Përkufizime sipas UNODC [Counter-Terrorism Module 2 Key Issues: Radicalization & Violent Extremism \(unodc.org\)](https://www.unodc.org/)

<sup>27</sup> Raporti i Raportuesit Special për gradimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ndërsa kundër terrorizmit [Microsoft Word - A HRC 16 51 FOR PROCESSING.doc \(ohchr.org\)](https://www.ohchr.org/)

dhe më indirekte, si dhe nëpërmjet mjeteve të dhunshme ose mjeteve të qarta, duke përfshirë terrorizmin. Ekstremizmi mund të avokohet nga aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë.<sup>28</sup>

- Teoritë Konspirative

Një teori konspirative është një besim se një grup që vepron në fshehtësi po përpiqet të kontrollojë proceset politike ose sociale për interesa personale dhe me pak lidhje me të mirën e përbashkët. Në këtë raport, fokusohe mi teoritë konspirative me potencial për të shkaktuar dëm në botën reale dhe potencialin për të krijuar terren prodhues për ideologjitë ekstremiste.<sup>29</sup>

- Antisemitizëm

Sipas përkufizimit të Aleancës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit (IHRA) për antisemitizmin: "Antisemitizëm është një perceptim i caktuar i hebrenjve, i cili mund të shprehet si urrejtje ndaj hebrenjve. Manifestimet retorike dhe fizike të antisemitizmit janë të drejtuara ndaj individëve hebrenj ose johebrenj dhe/ose pronës së tyre, ndaj institucioneve të komunitetit hebre dhe objekteve fetare."<sup>30</sup> Për efekt të analizës së monitorimit, tek kategoria e përmbajtjeve antisemite janë përfshirë ato që lidhen me antisemitizmin, që kanë elemente antisemite.

- Përmbajtje të tjera ekstremiste

Si përmbajtje të tjera ekstremiste janë klasifikuar ato përmbajtje që kanë cilësinë e të qenit ekstreme ose përhapin ide, besime apo besëtytni ekstreme të cilat ndikojnë në keq-orientimin e shoqërisë, përfshirë edhe duke ngjallur frikë apo panik. Të tilla përmbajtje lidhen me magjitë ose materiale të tjera.

- Përmbajtje neutrale

Neutraliteti i përmbajtjes i referohet përgjithësisht botimeve që janë pa paragjykime, që përfaqësojnë të gjitha pikëpamjet në mënyrë të drejtë.<sup>31</sup> Këtu kemi klasifikuar lajmet informuese objektive në përgjithësi të cilat i trajtojnë informacionet apo ngjarjet që lidhen me ideologjitë fetare, ekstremizmin, dhunën, dhe jo vetëm, në mënyrë objektive të paanshme, duke informuar audiencën.

- Përmbajtje fetare

Përmbajtja fetare nënkupton shkrimin e shenjtë, tekstin e shenjtë dhe shkrimet, ose fragmente prej tyre; materialet e shkruara të përdorura gjatë shërbesave të adhurimit ose festimeve fetare; dhe materialet të shkruara që përshkruajnë, shpjegojnë, analizojnë, avokojnë ose pro ose kundër; praktikatat dhe/ose besimet e një feje. Ai përfshin gjithashtu materialet që festojnë festat fetare.<sup>32</sup>

<sup>28</sup> [NZ-Online-Extremism-Findings-Report.pdf](#)

<sup>29</sup> [NZ-Online-Extremism-Findings-Report.pdf](#)

<sup>30</sup> Deklaratë për shtyp e Aleancës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit (IHRA) [press\\_release\\_document\\_antisemitism.pdf \(holocaustremembrance.com\)](#)

<sup>31</sup> Bazuar mbi përkufizimin, neutraliteti i përmbajtjes [Content Neutrality Law and Legal Definition | USLegal, Inc.](#)

<sup>32</sup> Përkufizim, përmbajtje fetare [Religious content Definition | Law Insider](#)



## 4. ANALIZA E MONITORIMIT

---

Kërkimi është përqendruar në monitorimin e platformave online (faqe interneti, bloge, rrjete sociale, etj.) të përdorura edhe nga përdoruesit shqiptarë, si Web, Facebook, Twitter, YouTube, Instagram, Telegram, LinkedIn, Reddit, Vimeo, Quora, Pinterest, dhe Lojëra Online, për raste të përhapjes së propagandave apo influencimit të pikëpamjeve të caktuara me karakter ekstremist, që mund të çojnë në radikalizëm apo ekstremizëm të dhunshëm. Në fazën kur dikush ka ndjekur një hashtag apo i është bashkuar një grupi në mediat sociale, ka të ngjarë që tashmë ka treguar interes ndaj asaj ideologjie.

Nga hulumtimi u konstatua se, në Shqipëri ekzistojnë faqe të shumta web-i si dhe llogari në rrjete sociale, të cilat mund të përdoren për të përhapur ideologji ekstremiste. U vu re gjithashtu se ka llogari me emra të rremë dhe të dhëna të pasakta ose jo-publike që shpërndajnë përmbajtje me elemente të ekstremizmit në Shqipëri në gjuhën shqipe, angleze edhe arabe dhe llogari me emra të huaja që shpërndajnë përmbajtje në gjuhën shqipe, por me vendndodhje që ishte e pamundur të identifikohesh gjatë kësaj periudhe monitorimi kur bëhej analiza e secilit link të gjeneruar nga mjetet e kërkimit. Megjithatë, mjetet e kërkimit i kanë nxjerrë të gjitha të dhënat për Shqipërinë, pra nënkuptohet që vendndodhja nga ku veprojnë këta përdorues është Shqipëria. Mundësia që ofrojnë rrjetet sociale për fshehjen e të dhënave dhe anonimitin e përdoruesve krijoi vështirësi për analizimin e të dhënave dhe klasifikimin e përdoruesve në mënyrë të saktë sipas gjinisë dhe moshës.

Nga procesi i monitorimit me anë të programeve “BrandMentions”, “Brand24” dhe “Social Searcher” u gjetën përmbajtjet në të cilat përmenden fjalët kyçe që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. U identifikuan 289 linke të gjeneruara, nga të cilat u konsideruan për analizë të detajuar linket në të cilat u gjetën përmbajtje me potencial më të lartë për t’u klasifikuar në kategoritë e mësipërme. Për pjesën tjetër të linkeve, pasi u shqyrtuan, u arrit në përfundimin se nuk kishin përmbajtje të vlefshme për monitorimin, pavarësisht se në to përmendeshin fjalët kyçe.

### 4.1 MEDIAT SOCIALE

Mediat sociale janë aplikacione dhe website interaktive në internet që lehtësojnë krijimin dhe ndarjen e përmbajtjes, informacionit, ideve, interesave dhe formave të tjera të shprehjes së krijuar nga përdoruesit brenda grupimeve dhe rrjeteve virtuale.<sup>33</sup> Në veçanti, platformat e mediave sociale mund të lehtësojnë krijimin e zhvillimin e rrjeteve shoqërore në internet që tërheqin vëmendjen e përdoruesve drejt propagandës dhe informacioneve të tjera, duke lejuar ndarjen e lehtë të një informacioni të tillë. Kjo u mundëson përdoruesve të gjejnë individë ose grupe të tjera me interesa të përbashkëta dhe të zgjerojnë rrjetet e tyre. Mediat sociale përdoren shpesh nga grupe të caktuara për të përhapur propagandë rreth radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, përfshirë këtu rrjete sociale si: Facebook, Instagram, Twitter, Telegram, dhe të tjera.

<sup>33</sup> J. Obar, “Përkufizimi i mediave sociale dhe sfida e qeverisjes: një hyrje në çështjen speciale”, 2015 [https://www.researchgate.net/publication/315490381\\_Social\\_Media\\_Definition\\_and\\_the\\_Governance\\_Challenge\\_An\\_Introduction\\_to\\_the\\_Special\\_Issue](https://www.researchgate.net/publication/315490381_Social_Media_Definition_and_the_Governance_Challenge_An_Introduction_to_the_Special_Issue)

#### 4.1.1 FACEBOOK<sup>34</sup>

Statistikat tregojnë se në Shqipëri shkalla e penetrimit të Facebook në janar të vitit 2022 arrinte në rreth 67.8% të popullsisë dhe numri i përdoruesve të Facebook, arrinte në rreth 1,947,600 përdorues në Shqipëri, duke qënë media sociale me shtrirje më të madhe në vend.<sup>35</sup>


Gjatë kërkimit të fjalëve kyçe u vu re se rrjeti social Facebook përdoret më së shumti nga përdoruesit që përhapin propagandë fetare me prirje ekstremiste në gjuhën shqipe. Pavarësisht se u konstatuan disa përdorues me llogari fiktive dhe disa organizata me profile të dyshimta fetare, u mundësua një analizë e detajuar e përdoruesve dhe përmbajtjes që ata ndajnë me të tjerët.

Në Facebook u konstatuan gjithsej 17 llogari dhe 23 linke me përmbajtje, nga ku:

- 13 linke u klasifikuan si propagandë fetare;
- 2 linke u klasifikuan si përmbajtje fetare;
- 6 linke u klasifikuan si diskriminim fetar;
- 2 linke u klasifikuan si ekstremizëm politik i të djathës ekstreme;
- 1 link u klasifikua si dezinformim.

Pas analizës u vu re se e njëjta përmbajtje mund të klasifikohet në dy ose më shumë kategori njëherësh pasi ka pasur disa raste për shembull ku e njëjta përmbajtje transmeton propagandë fetare dhe nxit diskriminimin fetar njëkohësisht.

Për kategoritë e tjera të përmbajtjeve, nuk u gjetën linke në facebook për periudhën e monitorimit.



*Fig1 : Nr. i linkeve të gjetura në Facebook nga përdorues që përhapin përmbajtje sipas kategorive të përcaktuara*

<sup>34</sup> Sipas Shtojcës 2, referencat e gjetura nga Facebook.

<sup>35</sup> Statistika <https://www.internetworldstats.com/europa2.htm>

Për secilën nga kategoritë e përmbajtjes u konstatua si më poshtë:

- **Propaganda fetare**  
Pëlqimet 83948;
- **Ekstremizmi politik i të djathtës ekstreme**  
Pëlqimet 134; Komente 7
- **Diskriminimi fetar**  
Pëlqimet 48037;
- **Përmbajtje fetare**  
Pëlqimet 11777; Komente 8
- **Dezinformim**  
Pëlqimet 89 ; Komente 6

#### 4.1.2 YOUTUBE<sup>36</sup>

Pas Facebook, u analizuan të dhënat e gjetura për Youtube dhe u nxorën rezultatet përkatëse. Në faqet shqiptare të YouTube, përveç mediave profesioniste, publikojnë video edhe mijëra qytetarë, duke krijuar në këtë mënyre një hapësirë të pasigurt, ku ekziston mundësia për ekspozim të përdoruesve ndaj përmbajtjeve me fokus radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Në YouTube, për periudhën e monitorimit, u gjetën 3 linke dhe 2 llogari ku dy prej tyre u klasifikuan si përmbajtje fetare dhe një si teori konspirative.

Në Youtube, për periudhën e monitorimit, u konstatuan gjithsej 2 llogari dhe 3 linke me përmbajtje, nga ku:

- 2 linke u klasifikuan si përmbajtje fetare;
- 1 link u klasifikua si teori konspirative;

Shikimet e përmbajtjeve fetare ishin 1793 dhe pëlqimet e tyre ishin në total 45.

Shikimet e përmbajtjes së klasifikuar si teori konspirative ishin 19 000, pëlqimet ishin 93 dhe komente ishin 18.




Fig 2: Nr. linkeve në youtube që përhapin përmbajtje sipas kategorive në grafik

<sup>36</sup> Sipas Shtojcës 2, referencat e gjetura nga Youtube.

### 4.1.3 INSTAGRAM

Në rrjetin social Instagram u gjetën 34 linke me përmbajtje të cilat janë klasifikuar sipas kategorive si vijon:

- 8 linke u klasifikuan si përmbajtje fetare;
- 3 linke u klasifikuan si propagandë fetare;
- 23 linke u klasifikuan si propagandë anti-fetare;




Fig 3: Nr. linkeve në Instagram që përhapin përmbajtje sipas kategorive në grafik

Për secilën nga kategoritë e përmbajtjes u konstatua si më poshtë:

- **Propaganda anti-fetare**  
Pëlqimet 931; Komente 9
- **Propaganda fetare**  
Nuk u gjet informacion mbi pëlqimet dhe komentet.
- **Përmbajtje fetare**  
Pëlqimet 1180; Komente 0

### 4.1.4 TWITTER

Në rrjetin social Twitter u gjetën 3 linke me përmbajtje të cilat janë klasifikuar sipas kategorive si vijon:

- 2 linke u klasifikuan si ekstremizëm islamist;
- 1 link u klasifikua si propagandë fetare.




Fig 4: Nr. linkeve në Twitter që përhapin përmbajtje sipas kategorive në grafik

Për secilën nga kategoritë e përmbajtjes u konstatua si më poshtë:

- **Propaganda fetare**  
Shikime 104; Pëlqime 1
- **Ekstremizmi islamist**  
Shikime 176; Pëlqime 2

#### 4.1.5 TELEGRAM, TIKTOK, REDDIT, VIMEO, LOJËRA<sup>37</sup>

Në rrjetet sociale Telegram, TikTok, Reddit, Vimeo, dhe lojëra u gjetën 17 linke me përmbajtje, të cilët përhapin më së shumti propagandë fetare si dhe përmbajtje fetare.

Respektivisht:

- Në Telegram u gjet 1 kanal me titull “Mesazhi Profetik”, dhe si ndjekës kishte 620 abonentë. U vu re që në disa postime kishte shikueshmëri më të lartë se numri i abonentëve. Ky kanal përmbante 863 linke, 140 video dhe 795 fotografi. U klasifikuan si përmbajtje fetare.
- Në TikTok nuk u gjet asnjë link për periudhën e monitorimit.
- Në Reddit u gjetën 13 linke ku:
  - 4 linke u klasifikuan si përmbajtje fetare (Pëlqime 13, Komente 8);
  - 1 link u klasifikua si propagandë antifetare (Pëlqime 0, Komente 5)
  - 8 linke u klasifikuan si propagandë fetare (Pëlqime 124, Komente 155)
- Në Vimeo u gjet 1 llogari pasi u gjenerua nga mjetet e monitorimit 1 link me përmbajtje që u klasifikua si ekstremizëm islamist. Kishte 40 video dhe 8 ndjekës.
- Lidhur me lojërat, u gjetën 2 linke ku një link u klasifikua si propagandë anti-fetare (0 pëlqime, 5 komente) dhe linku tjetër u klasifikua si propagandë fetare (57 pëlqime, 14 komente).

<sup>37</sup> Sipas shtojcës 2, linket e gjetura nga twitter, instagram, telegram

Në lidhje me lojërat elektronike, përdoruesit e këtyre lojërave përfshihen gjithashtu në situata që ndikojnë në psikologjinë e tyre, si psh. “Vrasin në këmbim të marrjes së parasë dhe kalimit të misioneve”, gjë e cila krijon sjellje agresive, që në moshë të hershme. Përveç përmbajtjes së dhunës, lojërat online mund të përmbajnë urrejtje etnike dhe fetare. Sjellje të cilat demonstrohen nga ata në ambientet e shkollës me fëmijët e tjerë. Sa i përket rrezeve sociale, web faqet e lojërave kanë mundësi të integrojnë video mesazhe dhe mundësi komunikimi verbal, gjë që mund të përdoret nga persona dashakeqës për të marrë informacione personale. Këta individë mund të vendosin marrëdhënie shoqërore me fëmijët, hiqen se janë moshatarë të tyre apo ndonjë i rritur, tek i cili mund të kenë besim, e më vonë përpiqen t’i bindin që të takohen drejtpërdrejt. Çfarë vihet re në këtë monitorim është se lojërat po përdoren për të çuar përpara agjenda kulturore, politike dhe fetare, kryesisht arabe, duke krijuar situata të integruara si pjesë të lojërave që përhapin mesazhe për këtë qëllim, përfshirë edhe me prirje të ekstremizmit të dhunshëm, duke simuluar gjatë lojës situata lufte dhe misone ushtarake në nivele të ndryshme në zbatim të këtyre ideve.

Bazuar mbi këtë monitorim të rrjeteve sociale është ndërtuar tabela në Figurën 5, e cila ofron informacion mbi numrin e link-eve të gjetura që përhapin radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Mbitotëruese janë linket që përhapin ekstremizëm me përmbajtje fetare, por prezentë janë edhe referencat me prirje ekstremizmi politik/ dhuna politike, linke të cilat përmbajnë informacion dhe pikëpamje ekstremiste rreth luftërave etnike, implikime terroristësh në Shqipëri, ekstremizëm islamik dhe diskriminimin fetar.




Fig 5: Numri i link-eve të gjetura sipas kategorive të përmbajtjeve për rrjetet sociale



## 4.2 FAQET WEB<sup>38</sup>

Analiza e monitorimit dy mujor të faqeve web konfirmon përdorimin e internetit dhe komunikimit online për përhapjen e ideologjive të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, më së shumti në natyrë përshkruese në formën e përmbajtjeve neutrale dhe përmbajtjeve fetare. Nga link-et e kërkua në faqe interneti, u gjeneruan:

- 68 linke, të cilat kishin përmbajtje neutrale;
- 4 linke që përmbanin diskriminimin fetar;
- 1 link që përmbante implikime ekstremistësh dhe terroristësh;
- 4 linke që kishin përmbajtje të lidhur me konfliktin dhe luftën etnike;
- 1 link që përmbante ekstremizmin politik;
- 1 link që përmbante antisemitizëm;
- 2 linke që kishin përmbajtje fetare;
- 1 link që përmbante propagandë fetare;
- 2 linke që përmbanin teori konspirative;
- 1 link ku u gjet një material që klasifikohet tek kategoria përmbajtje të tjera ekstremiste.





Fig 6: Nr. linkeve në faqet web që përhapin përmbajtje sipas kategorive në grafik

## 4.3 REFERENCA TË GJETURA SIPAS FJALËVE KYÇE


Gjatë kërkimit për të gjitha fjalët kyçe, u gjeneruan nga mjetet e kërkimit online 355 linke në total, nga të cilat 158 linke u gjeneruan për fjalët kyçe të përgjithshme dhe 197 linke u gjeneruan për të fjalëve kyçe me risk të lartë.

<sup>38</sup> Sipas shtojcës 2, Referencat e gjetura nga faqet web



*Fig. 7: Numri në % i linkeve të gjetura për fjalët kyçe në total*

Për 289 linket e gjetura në total, u analizuan dhe filtruan përmbajtjet e tyre dhe u konsideruan si të vlefshme për të zhvilluar analizën dhe statistikën e monitorimit vetëm ato të cilat mund të klasifikoheshin në kategoritë e përmbajtjeve të shpjeguara më lart. Nga këto, 57 linke u gjeneruan kur u kërkua me anë të fjalëve kyçe të përgjithshme dhe 95 linke u gjeneruan kur u kërkua me anë të fjalëve kyçe me risk të lartë. Fakti që këto përmbajtje u gjeneruan nga kërkimi me fjalë kyçe me risk të lartë nuk do të thotë domosdoshmërisht se edhe përmbajtjet ishin me risk të lartë, pasi u konstatua se kishte dhe përmbajtje neutrale dhe përmbajtje fetare.



*Fig 8: Numri në % i linkeve të gjetura për fjalët kyçe pas filtrimit*

#### 4.4 GJINIA E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË PËRHAPJEN E PËRMBAJTJEVE EKSTREMISTE NË INTERNET

Pas analizës, nga përdoruesit gjinia e të cilëve mund të identifikohet, përdorueset femra rezultojnë të jenë të përfshira më pak në propagandimin e ideologjive ekstremiste të dhunshme se sa përdoruesit burra, ku 22% janë femra dhe 78% janë burra.




Fig 9: Gjinia e personave të përfshirë në përhapjen e përmbajtjeve ekstremiste online

#### 4.5 KRAHASIMI ME MONITORIMIN E VITIT 2019

Bazuar në rezultatet e raportit të monitorimit të ASP në periudhën Nëntor – Dhjetor 2019<sup>39</sup>, u realizua një analizë krahasuese me rezultatet e raportit aktual. Ajo çfarë vihet re është se nga 107 linke të gjetura në raportin e publikuar në vitin 2019, aktualisht 39 prej tyre nuk janë më të aksesueshme. Pjesa që mbetet janë përmbajtje të vjetra, ku në rastet kur këto janë me prirje ekstremiste, është e nevojshme që të bllokohen/fshihen, duke u siguruar që të respektohet liria e fjalës, e medias dhe e besimit fetar.

Sa i përket rezultateve për rrjetet sociale, konstatohet se për rrjetet sociale:

- Në Facebook dhe Instagram, propaganda fetare/anti-fetare vijon të jete kategoria më e përhapur.
- Në Youtube, kategoria e përmbajtjeve më e përhapur në vitin 2019 ishte propaganda fetare, tashmë konstatohet më i përhapur kategorizimi përmbajtje fetare.
- Në Twitter, kategoria e përmbajtjeve më e përhapur në vitin 2019 ishte propaganda fetare kurse në vitin 2022 është ekstremizmi islamist.

<sup>39</sup> Raporti, "The violent extremism propaganda circulating on online platforms in Albania" 2020 [Monitoring\\_report\\_CVE\\_ENG-converted\\_\(1\).pdf](#)

Lidhur me rrjetet e tjera sociale, dominon propaganda fetare. Një lehtësim i situatës konstatohet në hapësin e websiteve, ku në vitin 2022 konstatohet përmbajtja neutrale si më e hasur, ndryshe nga viti 2019 kur rezultonte propaganda fetare.

## 5. PËRFUNDIME

---

Platformat e ndryshme online, të tilla si rrjetet e ndryshme sociale, vijnë të përdoren nga individë dhe grupe, të cilët shfrytëzojnë anonimitetin, mungesën e mbikëqyrjes së këtyre platformave, mungesën e politikave të vetë platformave në kufizimin e përmbajtjes së paligjshme si dhe lehtësinë e aksesit dhe koston e ulët të përdorimit, për të promovuar dhunën dhe gjuhën e urrejtjes mbi baza etnike, fetare, gjinore e kulturore, për të rekrutuar të rinjtë e për të krijuar komunitete online me shtrirje globale, në të cilat inkurajohen pikëpamjet e sjelljet e dhunshme, duke kontribuar kështu në proceset e radikalizimit.

Nga monitorimi i përdorimit të këtyre platformave online në një periudhë dy mujore u arrit në përfundimin se përmbajtjet për qëllim të përhapjes së ideologjive me pikëpamje ekstremiste, propagandës dhe radikalizimit janë aktualisht prezente dhe lehtësisht të arritshme.

Analiza e gjetjeve të monitorimit tregoi se pjesa më e madhe e materialeve të gjeneruara nga mjetet e kërkimit nuk ishin shprehimisht të dhunshme, por kryesisht me pikëpamje ideologjike me tendencë radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Disa përfundime kryesore nga monitorimi janë:

- Mediat sociale në Shqipëri vazhdojnë të luajnë një rol kryesor në përhapjen e ideologjive dhe propagandës fetare të cilat mund të krijojnë terrenin e favorshëm për ekstremizmin e dhunshëm. Në faqet web, mbizotëruese janë linket që përhapin përmbajtje neutrale. Në tërësi, në rrjetet sociale mbizotërojnë informacionet që klasifikohen si propagandë fetare dhe përmbajtje fetare, por prezente janë edhe referencat me prirje ekstremizmi politik/ dhuna politike, linke të cilat përmbajnë informacion dhe pikëpamje ekstremiste rreth luftërave etnike, implikime terroristësh në Shqipëri, ekstremizëm dhe diskriminim fetar.
- In 2022, a presence of conspiracy theories was found, motivated by the isolation measures and vaccination campaigns undertaken by the Albanian government and its allies during the Covid-19 pandemic. The same people and groups that share traditional religious messages also like and share online theories that denounce the control of Western governments by “globalist elites”, the “fakeness” of climate change or the “moral decadence” in the case of the rights of the LGBT community. Conspiracy theories can create motivation for disobedience to law enforcement authorities and oppositional actions of an extremist nature.
- Rrjeti social Facebook përdoret më së shumti nga përdoruesit që përhapin propagandë ekstremiste në gjuhën shqipe. Përmbajtje ekstremiste ekzistojnë edhe në llogaritë personale dhe të organizatave në Youtube, Twitter, Telegram dhe Instagram. Vëmendje duhet t'i kushtohet dhe lojtrave online, të cilat përvec modeleve të dhunës, krijojnë mundësinë për komunikim mes lojtarëve dhe përhapje të agjendave politike dhe fetare që ndikojnë në promovimin e pikëpamjeve me karakter esktrmist.

- Nga përdoruesit gjinia e të cilëve mund të identifikohet, rezulton që përdorueset femra janë më pak të përfshira në propagandimin e ideologjive ekstremiste të dhunshme se sa përdoruesit burra, ku 22% janë femra dhe 78% janë burra.
- Ndër kategoritë e përmbajtjeve më të përhapura online, mbetet shqetësuese prezenca e indoktrinimit me ideologji ekstremiste që synon individët më të manipulueshëm, të cilët mund të përdoren për qëllime të grupimeve terroriste në vendin e tyre, të ashtuquajturit “ujqërit e vetmuar”.

## 6. REKOMANDIME

Rreziku i shpërndarjes së propagandës ekstremiste dhe radikalizimi online nëpërmjet internetit dhe rrjeteve sociale vazhdon të jetë i lartë. Është shumë e rëndësishme që të konsiderohen hapat që mund të çojnë në kryerjen e akteve ekstremiste të dhunshme dhe terroriste, ku për të vendosur kontaktin e parë, rekrutuesit postojnë materiale propaganduese në mediat sociale për të gjetur dhe angazhuar shenjëstrat më të manipulueshme.

Strategjia e tyre përshin gjithashtu edhe krijimin e komuniteteve në internet ku inkurajohet ndarja e përmbajtjeve mes tyre, ndërveprimi dhe izolimi nga shoqëria dhe familja. Më pas kalohet në komunikime private, të cilat janë të vështira të monitorohen nga autoritetet, për të arritur objektivat përfundimtare të nxitjes së përdoruesve për të kryer veprat ekstremiste apo terroriste. Duke pasur parasysh këtë lloj skeme, është e rekomandueshme që autoritetet të fokusohen tek fazat e para duke realizuar monitorimin e përmbajtjeve online, identifikimin e aktorëve kryesorë dhe marrjen e masave ndaj tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Po ashtu, duke konsideruar sofistikimin e vazhdueshëm të strategjive, procedurave dhe mjeteve që grupet ekstremiste përdorin, është e nevojshme që këto të identifikohen në kohë dhe të adresohen me mjete ligjore për të ofruar një hapësirë më të sigurtë në internet nga ekstremizmi online.

Bazuar mbi gjetjet e këtij monitorimi si dhe praktikat më të mira bashkëkohore, mund të jepen disa rekomandime për politikëbërësit dhe aktorët e tjerë që përballen me sfidat e ekstremizmit të dhunshëm online:

- Rekomandohet zbatimi i plotë dhe efektiv i Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025, dhe Planit të Veprimit 2021 me qëllim përmirësimin e komponentit të Komunikimit Strategjik, koordinimit institucional dhe masave parandaluese me qëllim shkëmbimin e informacioneve në kohë për adresimin e personave në rrezik radikalizimi dhe krijimin e masave efikase për t’u ofruar mbështetje duke u kujdesur që të mos stigmatizohen dhe as akuzohen padrejtësisht.
- Forcimi i kapaciteteve të strukturave institucionale për monitorimin e vazhdueshëm dhe ndjekjen e sinjalizimeve që mund të vijnë nga operatorë privatë dhe përdorues individë mbi përmbajtjen e ekstremizmit të dhunshëm që qarkullon në platformat online në Shqipëri.
- Vendosja e kriterëve objektive në legjislacionin kombëtar lidhur me përcaktimin e një përmbajtje si kriminale, duke përfshirë mesazhet që qëllimisht komunikojnë ose nxisin në mënyrë direkte kryerjen e një veprimi terrorist, dhe që kanë një lidhje rastësore ndërmjet nxitjes dhe realizimit të mundshëm të dhunës ose veprimit terrorist.

- Për të realizuar heqjen/bllokimin e shpejtë të përmbajtjeve të rrezikshme në internet, nevojitet përditësimi i legjislacionit përkatës kombëtar dhe vendime gjyqate transparente dhe efikase. Çdo përpjekje për filtrimin apo bllokimin e përmbajtjes online duhet të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe në përputhje me normat e shtetit ligjor.
- Mbetet e rëndësishme që qasja ndaj rrezeve të ekstremizmit të dhunshëm të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe të përfshijë të gjithë aktorët dhe grupet e interesit duke mos u kufizuar vetëm tek politikën ndëshkuese.

Bazuar mbi **Rekomandimin e Komisionit Evropian COM(2017) 555<sup>40</sup>** dhe **Direktivën mbi terrorizmin (EU) 2017/541<sup>41</sup>**, mund të ofrohen gjithashtu disa masa konkrete që mund të ndërmerren nga autoritetet shqiptare me qëllim reagimin ndaj mesazheve ekstremiste dhe përmbajtjeve të paligjshme të tjera në platformat online :

- Rregullime ligjore për ofruesit e platformave online (faqe interneti, blogje, rrjete sociale etj) për të siguruar pika kontakti apo ndërfaqe teknike, të cilat mund të lejojnë sinjalizimin efektiv dhe në kohë të shpejtë të materialeve ekstremiste të dhunshme nga autoritetet zyrtare apo edhe sinjalizues vullnetarë, me qëllim fshirjen/bllokimin e këtyre materialeve apo profileve. Për këtë qëllim, mund të shfrytëzohet rregullimi ligjor dhe procedurat e ngritura dhe zbatuara së fundi nga Njësia e Referimit e Internetit pranë EUROPOL<sup>42</sup>.
- Hartimin e protokollove për ofruesit e shërbimit të internetit në ambiente publike si shkolla, qendra tregtare, bare apo edhe sheshe publike, duke synuar instalimin e filtrave, software të posaçëm apo masa të tjera inovative për të ndaluar aksesimin e përmbajtjeve të dëmshme në internet.
- Ofruesit e platformave online duhet të përcaktojnë në mënyrë të shprehur qartë në kushtet e tyre të shërbimit që ata nuk do të ruajnë materiale me përmbajtje ekstremiste. Kjo ofron një qasje më të pranueshme ndaj ankesave apo masave ligjore që mund të ndërmarrin personat e prekur nga fshirja e materialeve të debatueshme.

## SHTOJCA 1 - MOTORËT E KËRKIMIT

Mjeti i parë i kërkimit është social-searcher, nga ku gjenerohen analiza dhe statistika rreth fjalës kyçe për të cilën kërkohet. Konkretisht gjeneron përmbajtjen, sa here është përdorur fjala kyçe, tek cila faqe konkrete është përdorur dhe linkun e ridrejtimimit tek ajo faqe.

**URL Motorit të kërkimit:** <https://www.social-searcher.com/social-buzz/?wblng&ntw&spsttyp&searchid=0&period&value&fbpage&q5&abdullah+azzam+albania>

<sup>40</sup> Tackling Illegal Content Online – European Commission, 28.9.2017 <https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/1/2017/EN/COM-2017-555-F1-EN-MAIN-PART-1.PDF>

<sup>41</sup> Directive (EU) 2017/541 of the European Parliament and of the Council of 15 March 2017 on combating terrorism <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32017L0541>

<sup>42</sup> The EU Internet Referral Unit (EU IRU) <https://www.europol.europa.eu/about-europol/eu-internet-referral-unit-eu-iru>



## Social Searcher - Free Social Media Search Engine (social-searcher.com)

The screenshot displays the Social Searcher interface. At the top, there is a search bar with the query 'Amaq Agency albania'. To the right, there are buttons for 'SEARCH SETTINGS', 'email alerts', and 'monitoring'. Below the search bar, there are filters and a 'Sort by' dropdown set to 'Date'. A blue banner indicates 'Mentions: 119', 'Users: 30', and 'Sentiment: 1:1'. A 'DETAILED STATISTICS' button is visible. The main area shows a grid of search results, each with a 'SEARCH TIPS' section and a 'link' button. The tips include instructions like 'Check up exact phrase match' and 'Select language for more relevant results'.



Fig : Motor kërkimi për të gjeneruar analiza dhe statistika rreth fjalëve kyçe

Një mjet kërkimi tjetër është ai i Brand24, që përmes pagesës, ofron mundësinë e filtrimit të të dhënave posaçërisht për Shqipërinë, duke shkuar tek opsioni Analysis dhe zgjedhur filtrat sipas qëllimit të studimit, për shtetin që interesohemi të bëjmë monitorimin, në këtë rast Shqipëria.

[https://brand24.com/?adgr=txt-brand-iv-test&keyword-ext=brand24&placement&location=9069992&gclid=CjwKCAiAk--dBhABEiwAchlwXgrBeonR6IWYGK0PzWsh-9DbB6lajmr4wUodW-\\_IVw2T4IC38eqdxoCwmiQAvD\\_BwE](https://brand24.com/?adgr=txt-brand-iv-test&keyword-ext=brand24&placement&location=9069992&gclid=CjwKCAiAk--dBhABEiwAchlwXgrBeonR6IWYGK0PzWsh-9DbB6lajmr4wUodW-_IVw2T4IC38eqdxoCwmiQAvD_BwE)

The screenshot shows the Brand24 interface. On the left, there is a sidebar with 'PROJECTS' and 'Ekstremizëm' (0 New mentions). Below this are sections for 'Mentions', 'Summary', 'Analysis', 'Sources', 'Influencers', and 'Comparison'. Under 'REPORTS', there are options for 'Email reports', 'PDF report', 'Excel report', and 'Infographic'. The main area displays search results for 'Ekstremizëm të dhunshëm...' with a date range of 2022-11-01 to 2022-12-31. The results include a snippet from sot.com.al and another from lajmi.net. On the right, there are filters for 'Sources' (Facebook, Instagram, Twitter, TikTok, Videos, News, Podcasts, Forums, Blogs, Web) and 'Sentiment' (Negative, Neutral, Positive). There is also an 'Importance' filter.

dhëna sa herë është përmendur një fjalë kyçe, duke monitoruar në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, për shtetin që interesohemi të bëjmë monitorimin, në këtë rast Shqipëria, jep linket ku është përdorur si dhe mundëson raporte të detajuara për secilën fjalë kyçe.



## SHTOJCA 2 - LINKE TË GJETURA NGA MONITORIMI

Në këtë shtojcë janë përfshirë linket e gjetura, të cilat pas analizës janë klasifikuar në të paktën një nga kategoritë e përcaktuara të përmbajtjeve.

Kjo shtojcë është mbajtur konfidenciale për aktorët joinstitucionalë për shkak të informacionit sensitiv që mund të përmbajë.

## SHTOJCA 3 - FJALËT KYÇE PËR MONITORIM


### FJALËT KYÇE PËR MONITORIM TË PËRGJITHSHMEM


Apostasy  
Apostate  
Apostates  
Ayman al-Zawahiri  
Caliphate  
Crusader  
Crusaders  
Dabiq  
Dabiq Magazine  
Ibn Taymiyyah  
Islamic State  
Jihad  
Jihad Meaning  
Kafir  
Khalifa Meaning  
Khilafah  
Kuffar  
Martyr  
Martyrdom in Islam  
Martyrs  
Mujahideen  
Shahada  
Suicide Vest  
Hebre

### FJALËT KYÇE PËR MONITORIM ME RISK TË LARTË

Abdullah Azzam  
Amaq Agency  
Apostate Islam  
Apostates in Islam  
Beheadings  
Crusader Army  
Crusaders Against Islam  
Dabiq PDF  
How to do Jihad  
Ibn Taymiyyah Jihad  
Inspire Magazine  
Kabbalah  
Cabala  
Cabbala  
Cabbalah  
Jewish Coalition  
Jihad for Ummah  
Jihad in the Quran  
Khalifah  
Khilafah Syria  
Killing Apostates  
Killing Infidels  
Killing Kuffar  
Mujahid  
Preparing for Jihad  
Rafidah  
Soldiers of the Caliphate

Taghut  
Ameliye Istishadije  
Al-Qaeda  
Bidatci  
Dawla Islamiyyah  
Eksploziv  
Emir  
Ekstremizëm  
Haku  
Hawala  
Hixhara  
Ikhuani  
Khalifat  
LHT  
Muxhahid  
Muvahid  
Murtedat  
Munafik  
Murxhi  
Rafidijte  
Shehid  
Sherihat  
ISIL  
ISIS  
Shtet Islamik (Khalifat)  
Shirk  
Targut  
Tekfir  
Kabala  
Plandemi  
Kaurr







**Akademia e Studimeve Politike**

Rruga "Emin Duraku", Pallati Credins  
Hyrja 1, kati 7, Ap. 21  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 5629047,  
E-mail: [info@asp.al](mailto:info@asp.al)  
Web: [www.asp.al](http://www.asp.al)